 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE²

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

² Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE³

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

³ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	6	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Njesia	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (4 x 5X)	
1.	F.V. Shandan 3D + varg me drita	copë	50			
2.	F.V Pemë e madhe festive e ndriçuar dhe zbukurime total	copë	1			
3.	F.V Slitë dekorative për shoqërimin e pemës	copë	1			
4	F.V Arush dekorativ 2D për fotografim	copë	1			
5	F.V Element dekorativ tematik "Babagyshi" për shtylla – Modeli 1	copë	15			
6	F.V Element dekorativ tematik "Babagyshi" për shtylla – Modeli 2	copë	15			
7	F.V Element dekorativ tematik "Babagyshi" për shtylla – Modeli 3	copë	15			

8	F.V Element dekorativ tematik “Babagyshi” për shtylla – Modeli 4	copë	15			
9	F.V Hark dekorativ në formë dhurate me shkrimin “VLORA 2027”	copë	1			
10	F.V Element dekorativ për shtylla në formë ylli, me ndriçim, ngjyrë e kuqe ose gold	copë	55			
11	F.V Instalacion dekorativ hark me drerë mbi pedestal	copë	1			
12	F.V Sferë dekorative me drita, ngjyrë gold – Sheshi para Bashkisë	copë	10			
13	F.V Sferë dekorative me drita, ngjyrë gold – Sheshi i Flamurit	copë	20			
14	F.V Kornizë dekorative “Polaroid” për fotografim – Sheshi i Flamurit	copë	1			
	Çmimi total (Mallrat)				_____	
					—	
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit						
Nënshkrimi						
Vula						
Datë _____						

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

1. Kërkesa të Përgjithshme

Specifikimet teknike janë përpiluar në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknike në fuqi dhe përfaqësojnë kërkesat minimale të detyrueshme për realizimin e shërbimit. Të gjitha materialet duhet të jenë të reja, të papërdorura më parë, në gjendje të mirë teknike dhe të përshtatshme për përdorim në ambiente të jashtme. Elementet duhet të jenë të qëndrueshme, të sigurt dhe të përshtatshme për vendosje në hapësira publike. Çdo referencë ndaj materialeve, produkteve, teknologjive, standardeve apo përshkrimeve teknike nënkupton materiale ose zgjidhje teknike ekuivalente, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Ndriçimi LED dhe komponentët elektrikë duhet të jenë të përshtatshëm për përdorim të jashtëm, me mbrojtje IP65 ose ekuivalente. Strukturat duhet të fiksohen në mënyrë të sigurt dhe të garantojnë qëndrueshmëri gjatë periudhës së përdorimit.

2. Tabela e Specifikimeve Teknike

Nr.	Emërtimi i elementit	Specifikimet teknike minimale	Përmasat
1	F.V. Shandan 3D me perde	Strukturë metalike, e mbështjellë me dritë LED IP65 ose ekuivalente. LED konveks Ø4.8 mm, kapak silikoni transparent i mbushur Ø6.3 mm, me tub termotkurrës transparent, për përdorim të jashtëm. Përfundimi dhe shpërndarja e dritës duhet të jenë të njëtrajtshme dhe struktura e qëndrueshme.	600 × 130 × 90 cm
2	F.V.Pemë e madhe festive e ndriçuar	Strukturë metalike me degë plastike, e mbuluar me dekore dhe ndriçim LED IP65 ose ekuivalent. LED konveks Ø4.8 mm, kapak silikoni transparent i mbushur Ø6.3 mm, me tub termotkurrës transparent, për përdorim të jashtëm.	H = 1050 cm
3	F.V Slitë festive me drerë	Strukturë metalike, e mbështjellë me dritë LED IP65 ose ekuivalente dhe me rrjetë akrilike transparente. LED konveks Ø4.8 mm, kapak silikoni transparent i mbushur	Slita: 320 × 120 × 160 cm; Dreri: 200 × 310 cm

		Ø6.3 mm, me tub termotkurrës transparent. Slita me metal të lyer me bojë të kuqe.	
4	F.V Ari 2D dekorativ	Strukturë metalike, e mbështjellë me dritë LED IP65 ose ekuivalente dhe me rrjetë PVC anti-UV në ngjyrë gold, me detaje të kuqe dhe të bardha. LED konveks Ø4.8 mm, kapak silikon transparent i mbushur Ø6.3 mm, me tub termotkurrës transparent.	300 × 220 × 25 cm
5	F.V Dekor shtyllë – modele të ndryshme	Strukturë metalike, e mbështjellë me dritë LED IP65 ose ekuivalente. LED konveks Ø4.8 mm, kapak silikon transparent i mbushur Ø6.3 mm, me tub termotkurrës transparent. Realizohet sipas modeleve të përcaktuara në materialin ilustrues.	Modeli 1: 134 × 121 cm; Modeli 2: 163 × 132 cm; Modeli 3: 183 × 126 cm; Modeli 4: 133 × 145 cm
6	F.V Kuti dhuratë dekorative	Strukturë metalike, e mbështjellë me dritë LED IP65 ose ekuivalente. LED konveks Ø4.8 mm, kapak silikon transparent i mbushur Ø6.3 mm, me tub termotkurrës transparent. E mbështjellë me rrjetë PVC anti-UV ngjyrë gold dhe fjongo të kuqe.	340 × 330 × 90 cm
7	F.V Dekor shtyllë me rrjetë akrilike të kuqe	Strukturë metalike, e mbështjellë me dritë LED IP65 ose ekuivalente. LED konveks Ø4.8 mm, kapak silikon transparent i mbushur Ø6.3 mm, me tub termotkurrës transparent. E mbështjellë me rrjetë akrilike në ngjyrë të kuqe.	92 × 220 cm
8	F.V Dekor shtyllë me ndriçim LED	Strukturë metalike, e mbështjellë me dritë LED IP65 ose ekuivalente. LED konveks Ø4.8 mm, kapak silikon transparent i mbushur Ø6.3 mm, me tub termotkurrës transparent, për përdorim të jashtëm. E përshtatshme për fiksime në shtyllat ekzistuese.	92 × 220 cm
9	F.V Hark dekorativ me figura drerësh mbi piedestal	Hark dekorativ me strukturë metalike, i përshtatshëm për përdorim të jashtëm dhe si pikë fotografimi. I mbështjellë me dritë LED IP65 ose ekuivalente; LED konveks Ø4.8 mm, kapak silikon transparent i mbushur Ø6.3 mm, me tub termotkurrës transparent. I mbështjellë me rrjetë akrilike transparente. Platforma/piedestali i mbështjellë me adeziv të kuq. Duhet të	H = 500 cm

		fiksohet dhe të garantojë stabilitet e siguri në hapësirë publike.	
10	F.V Sferë dekorative me drita	Strukturë metalike e mbështjellë me dritë LED IP65 ose ekuivalente. LED konveks Ø4.8 mm, kapak silikon transparent i mbushur Ø6.3 mm, me tub termotkurrës transparent, për përdorim të jashtëm.	Ø 50 cm; Ø 70 cm; Ø 100 cm
11	F.V Kornizë Polaroid	Strukturë metalike, e mbështjellë me dritë LED IP65 ose ekuivalente. LED konveks Ø4.8 mm, kapak silikon transparent i mbushur Ø6.3 mm, me tub termotkurrës transparent. E mbështjellë me akrilik transparent anti-UV; pjesa dekorative me rrjetë PVC anti-UV në ngjyrë të kuqe dhe të bardhë. E përshtatshme si pikë fotografimi.	268 × 33 × 29 cm

3. Kërkesa për Montimin, Fiksimin dhe Sigurinë

Të gjithë elementët duhet të dorëzohen, montohen dhe vendosen në gjendje të plotë funksionale dhe estetike. Strukturat metalike dhe elementët dekorativë duhet të jenë të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm për kushtet e jashtme. Fiksimi duhet të garantojë siguri dhe stabilitet, duke shmangur rrezikun e rrëzimit, përmbykses ose dëmtimit të personave dhe pronës publike. Lidhjet dhe komponentët elektrikë duhet të jenë të mbrojtur dhe të përshtatshëm për përdorim të jashtëm. Vendosja do të kryhet në pozicionet e përcaktuara nga Bashkia Vlorë, pa dëmtuar infrastrukturën publike. Sipas nevojës, kontraktori duhet të kryejë ndërhyrjet e nevojshme për mirëmbajtjen dhe funksionalitetin e elementeve gjatë periudhës së dekorimit, si dhe çmontimin e tyre në përfundim të periudhës së përcaktuar.

4. Material Ilustrues

Materiali vizual ilustrues i elementeve dekorative do të vendoset si Aneks/Bashkëlidhje në fund të këtij dokumenti. Pamjet shërbejnë për identifikimin dhe qartësimin e formës, modelit, konfigurimit dhe karakteristikave vizuale të elementeve. Materiali ilustrues lexohet së bashku me specifikimet teknike.



Shandan 3D me perde me strukturë metalike dhe e mbështjellë me dritë me Led IP65, konvekse me diametër 4.8mm, kapak silikoni transparent i mbushur, me diametër 6.3 mm, me tub termotkurrës transparent ,për përdorim të jashtëm.

Përmasat

600 x 130 x 90 cm.



Pemë e madhe me strukturë metalike dhe me degë plastike dhe e mbuluar me dekore dhe me dritë me Led IP65, konvekse me diametër 4.8mm, kapak silikoni transparent i mbushur, me diametër 6.3 mm, me tub termotkurrës transparent ,për përdorim të jashtëm.

Përmasat

H=1050cm.



Slitë me drere dreret me strukture metalike dhe të mbështjellë me dritë me Led IP65, konvekse me diametër 4.8mm, kapak silikoni transparent i mbushur, me diametër 6.3 mm, me tub termotkurrës transparent ,për përdorim të jashtëm, si dhe të mbështjellë me rrjete akrilike transparente; slita me metal të lyer me bojë të kuqe.


SLITA Permasat 320x120x160cm dhe
DRERI Permasat 200x310cm.



Ari 2D me strukturë metalike dhe i mbështjellë me dritë me Led IP65, konvekse, me diametër 4.8mm, kapak silikon transparent i mbushur, me diametër 6.3 mm, me tub termotkurrës transparent, për përdorim të jashtëm si dhe i mbështjellë me rrjetë pvc, anti uv ngjyrë gold me detaje të kuqe dhe të bardha. Përmasat 300 x 220 x 25 cm.



Dekor shtyllë me strukturë metalike dhe e mbështjellë me dritë me Led IP65, konvekse me diametër 4.8mm, kapak silikon transparent i mbushur, me diametër 6.3 mm, me tub termotkurrës transparent, për përdorim të jashtëm. **Përmasat janë:** 1. 134 x 121 cm 2. Përmasat 163 x 132 cm 3. Përmasat 183 x 126 cm dhe 4. 133 x 145 cm.





Kuti dhuratë me strukturë metalike dhe e mbështjelle me dritë Led IP65, konveske me diametër 4.8 mm, kapak silikon transparent i mbushur, me diametër 6.3 mm, me tub termotkurrës transparent, për përdorim të jashtëm si edhe e mbështjellë me rrjetë pvc, anti uv ngjyrë gold dhe fjongo e kuqe. Përmasat 340 x 330 x 90 cm.



Dekor shtylle me strukturë metalike dhe e mbështjellë me dritë me Led IP65, konvekse me diametër 4.8mm, kapak silikon transparent i mbushur, me diametër 6.3 mm, me tub termotkurrës transparent, për përdorim të jashtëm, dhe i mbështjellë dhe me rrjete akrilike ngjyrë të kuqe.

Permasat

92x220cm



Dekor shtylle me strukturë metalike dhe e mbështjellë me dritë me Led IP65, konvekse me diametër 4.8mm, kapak silikon transparent i mbushur, me diametër 6.3 mm, me tub termotkurrës transparent, për përdorim të jashtëm. Permasat 92 x 220 cm.



Hark me Dre në pedestal me strukturë metalike dhe e mbështjellë me dritë LED IP65, konvekse me diametër 4.8 mm, kapak silikon transparent i mbushur, me diametër 6.3 mm , me tub termotkurrës transparent, për përdorim të jashtëm si dhe e mbështjellë me rrjetë akrilike transparente, platformë e mbështjellë me adeziv të kuq. Përmasat H= 500 cm.



Sferë me drita me strukturë metalike dhe e mbështjellë me dritë me Led IP65, konvekse me diametër 4.8 mm, kapak silikon transparent i mbushur , me diametër 6.3 mm me tub termotkurrës transparent , për përdorim të jashtëm. Përmasat 50CM, 70 CM dhe 100 CM.



Kornizë polaroid me strukturë metalike dhe e mbështjellë me dritë Led IP65, konvekse me diametër 4.8 mm , kapak silikon transparent i mbushur, me diametër 6.3 mm, me tub termotkurrës transparent, për përdorim të jashtëm si edhe mbështjellë me akrilike transparente, anti uv transparente dhe kapuci i mbështjellë me rrjetë pvc anti uv ngjyrë e kuqe dhe e bardhë. Përmasat 268 x 33 x 29 cm.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e levrimit: 20 dite me lidhjen e kontrates

Artikulli	Përshkrimi	Njesia	Sasia	Afati i levrimit
1	F.V Shandan 3D + varg me drita	copë	50	Sipas afatit te MK
2	F.V. Pemë e madhe festive e ndriçuar dhe zbukurime total	copë	1	Sipas afatit te MK
3	F.V. Slitë dekorative për shoqërimin e pemës	copë	1	Sipas afatit te MK
4	F.V. Arush dekorativ 2D për fotografim	copë	1	Sipas afatit te MK
5	F.V. Element dekorativ tematik “Babagjyshi” për shtylla – Modeli 1	copë	15	Sipas afatit te MK
6	F.V. Element dekorativ tematik “Babagjyshi” për shtylla – Modeli 2	copë	15	Sipas afatit te MK
7	F.V. Element dekorativ tematik “Babagjyshi” për shtylla – Modeli 3	copë	15	Sipas afatit te MK
8	F.V. Element dekorativ tematik “Babagjyshi” për shtylla – Modeli 4	copë	15	Sipas afatit te MK
9	F.V. Hark dekorativ në formë dhurate me shkrimin “VLORA 2027”	copë	1	Sipas afatit te MK

10	F.V. Element dekorativ për shtylla në formë ylli, me ndriçim, ngjyrë e kuqe ose gold	copë	55	Sipas afatit të MK
11	F.V. Instalacion dekorativ hark me drerë mbi pedestal	copë	1	Sipas afatit të MK
12	F.V Sferë dekorative me drita, ngjyrë gold	copë	10	Sipas afatit të MK
13	F.V Sferë dekorative me drita, ngjyrë gold	copë	20	Sipas afatit të MK
14	F.V. Kornizë dekorative “Polaroid” për fotografim	copë	1	Sipas afatit të MK

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimi/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e perlllogaritur e fondit limit**

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të viteve **2023, 2024 dhe 2025**, të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009, **“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”**, bilancet duhet të shoqërohen edhe me **raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore**, të kryera nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese, sipas përcaktimeve ligjore
Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për **këstet e maturuara të vitit 2026** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 5 (pesë) punonjës/personel të angazhuar për realizimin e objektit të prokurimit, të përshtatshëm për furnizimin, transportimin, montimin dhe vendosjen e elementeve dekorative, si më poshtë:

- **1 (një) dizenjator**, përgjegjës për përshtatjen dhe organizimin estetik të elementeve dekorative, në përputhje me specifikimet teknike dhe materialin ilustrues të përcaktuar në dokumentet e tenderit;
- **2 (dy) montues**, për montimin, vendosjen dhe fiksimin e elementeve dekorative, **të certifikuar për kryerjen e punimeve në lartësi**;;
- **2 (dy) punonjës**, për transportimin, ngarkim-shkarkimin e materialeve dhe elementeve dekorative, si dhe për asistencën gjatë procesit të montimit

Për personelin e mësipërm, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin, si:

- Dokument që provon marrëdhënien e punës ose angazhimin e personelit me operatorin ekonomik;
- Për **dizenjatorin**, dokument që provon angazhimin e tij në këtë funksion, si dhe dokumentacionin përkatës që dëshmon kualifikimin/profilin profesional të kërkuar;
- Për **2 (dy) montuesit**, dokumentacion që provon trajnimin e tyre për kryerjen e punimeve në lartësi;
- Vërtetim të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve të operatorit ekonomik për 3 (tre) muajt e fundit;
- Listëpagesat e punonjësve, sipas formatit të kërkuar nga legjislacioni në fuqi, për 3 (tre) muajt e fundit.

***Shënim:**Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3.3 Mjetet dhe pajisjet teknike

Operatori ekonomik duhet të disponojë, në pronësi ose me qira, ose t'i jenë vënë në dispozicion për realizimin e kontratës, minimalisht mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- a) **Kamionçinë me kapacitet deri në 3.5 ton** – 1 (një) copë, për transportimin e materialeve, pajisjeve dhe mbetjeve të krijuara gjatë realizimit të kontratës;
- b) **Platformë ajrore me lartësi pune jo me pak se 18 m** – 1 (një) copë, për realizimin e punimeve në lartësi.

Dokumentet provuese:

- për mjetet në pronësi, dokumentin që provon pronësinë dhe dokumentet e vlefshme të regjistrimit të mjetit;
- për mjetet me qira, kontratën e qirasë të vlefshme dhe dokumentet e mjetit;
- për mjetet/pajisjet e vëna në dispozicion nga një subjekt tjetër, dokumentin që provon vënien në dispozicion të tyre dhe dokumentet përkatëse të mjetit/pajisjes;
- për mjetet që regjistrohen në regjistra publikë, dokumentet e vlefshme të regjistrimit dhe përdorimit, sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë, sipas rastit, **lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit dhe dokumentin për pagesën e taksave;**
- për platformën ajrore, **dokumentacionin teknik** që provon karakteristikat dhe lartësinë e punës së saj.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë, për artikujt e ofertuar, katalogë, fletë teknike, materiale fotografike dhe/ose dokumentacion tjetër teknik të prodhuesit ose furnizuesit, në të cilin të identifikohen qartë karakteristikat teknike dhe funksionale të produkteve të ofruara. Dokumentacioni teknik duhet të jetë i mjaftueshëm për të mundësuar verifikimin e përputhshmërisë së produkteve të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, përfshirë përmasat, materialet, strukturën, karakteristikat e ndriçimit, mënyrën e përdorimit dhe kërkesat për përdorim në ambiente të jashtme.

Për produktet, komponentët ose materialet për të cilat parashikohet nga legjislacioni në fuqi, standardet përkatëse ose dokumentacioni teknik i prodhuesit, operatori ekonomik duhet të paraqesë, sipas rastit, certifikatë cilësie, deklaratë konformiteti dhe/ose dokument tjetër të vlefshëm që dëshmon përputhshmërinë e produktit me kërkesat teknike, të sigurisë dhe të cilësisë.

Për **komponentët elektrikë dhe sistemet e ndriçimit LED** të përdorura në elementet dekorative, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion teknik dhe, sipas rastit, **deklaratë konformiteti, certifikatë cilësie ose dokument tjetër të vlefshëm të prodhuesit,** nëpërmjet të cilit të verifikohet përputhshmëria e tyre me kërkesat teknike dhe të sigurisë të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Dokumentacioni duhet të mundësojë, ndër të tjera, verifikimin e përshtatshmërisë së komponentëve për **përdorim në ambiente të jashtme** dhe të nivelit të mbrojtjes së kërkuar, përfshirë **IP65 ose ekuivalent,** kur kjo kërkesë është përcaktuar në specifikimet teknike.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të lejojë identifikimin e **prodhuesit, modelit ose tipit të produktit/komponentit,** kur këto të dhëna janë të aplikueshme, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të mund të verifikojë përputhshmërinë e ofertës me kërkesat teknike të dokumenteve të tenderit.

Në rast se dokumentacioni teknik është në gjuhë të huaj, ai duhet të shoqërohet me **përkthimin përkatës në gjuhën shqipe.**

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon kapacitetet e nevojshme teknike, njerëzore dhe organizative për **furnizimin, transportimin, montimin dhe vendosjen në funksionim të elementeve dekorative**, në përputhje me specifikimet teknike dhe brenda afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----

Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁴.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

